VENDIM
Nr. 51, datë 17.2.2021

MBI MIRATIMIN E KONTRATËS NDËRMJET OST SHA DHE KESH SHA, "PËR SIGURIMIN E SHËRBIMIT TË BALANCIMIT, KAPACITETIT REZERVË DHE ENERGJISË BALANCUESE"

Në mbështetje të neneve 16 dhe 20, germa "h", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të nenit 105, germa "c", të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"; të vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 244, datë 30.3.2016, "Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike", të ndryshuar, si dhe të nenit 15 dhe 26, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 17.2.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 27/5 prot., datë 12.2.2021, të Drejtorive Teknike, mbi miratimin e kontratës ndërmjet shoqërisë Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST sh.a.) dhe shoqërisë Korporata Elektroenergjitike Shqiptare (KESH sh.a.) "Për sigurimin e shërbimit të balancimit, kapacitetit rezervë dhe energjisë balancuese",

konstatoi se:

- OST sh.a., me shkresën nr. 613/1 prot., datë 28.1.2021, ka përcjellë për miratim në ERE kontratën me nr. KESH/nr. 477/1 prot., dhe OST/nr. 613 prot., ndërmjet OST sh.a. dhe KESH sh.a., "Për sigurimin e shërbimit të balancimit, kapacitetit rezervë dhe energjisë balancuese".

- Me vendimin nr. 39, datë 6.3.2020, Bordi i ERE-s ka vendosur që, kontrata KESH/nr. 6651 prot., dhe OST/nr. 8859 prot., datë 31.12.2018, lidhur ndërmjet OST sh.a. dhe KESH sh.a., "Për sigurimin e shërbimit të balancimit, kapacitetit rezervë dhe energjisë balancuese", do të shtrijë efektet e përcaktuara në nenin 15 të saj, deri në miratimin nga ERE të kontratës "Për sigurimin e shërbimit të balancimit, kapacitetit rezervë dhe energjisë balancuese" për vitin 2020, të paraqitur nga palët në mungesë të burimeve të tjera të sigurimit të këtij shërbimi për OST sh.a.

- Përmes vendimit nr. 106, datë 2.7.2020, Bordi i ERE-s vendosi "Miratimin e rregullave të tregut shqiptar të balancimit të energjisë elektrike".

- Në vijim, me vendimin nr. 275, datë 28.12.2020, Bordi i ERE-s vendosi shtyrjen e afatit të zbatimit nga pjesëtarët e tregut të energjisë elektrike, pa efekte financiare (*dry run*) deri në datën 31.3.2021, të rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 106, datë 2.7.2020, sipërcituar, si dhe OST sh.a. dhe pjesëtarët e tregut të energjisë elektrike të vijojnë aplikimin e periudhës *dry run* deri në këtë datë.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 184, datë 20.8.2018, vendosi miratimin e "Kontratës për sigurimin e shërbimeve të balancimit (kapacitetit rezervë dhe energjisë balancuese) të sistemit elektroenergjitik për periudhën kohore 1.1.2018–31.12.2018" midis OST sh.a. dhe KESH sh.a.

- Për periudhën 2019–2020, vlen të theksohet se shërbimet ndihmëse dhe ato të balancimit për sistemin elektroenergjetik janë siguruar nga shoqëria KESH sh.a.

- Në pikën 2, të dispozitivit të vendimit sipërcituar, është përcaktuar se: "Çmimet dhe tarifat e përmendura në këtë kontratë nuk janë objekt i miratimit nga ERE".

- Për këtë arsye, çmimet e përcaktuara në nenin 9 të kontratës, nuk janë objekt i miratimit nga ana e ERE, pasi këto çmime janë të negociuara dhe të dakordësuara nga vetë palët OST sh.a. dhe KESH sh.a.

- Nga analiza e kontratës së përcjellë nga ana e shoqërisë OST sh.a. përmes shkresës nr. 613/1 prot., datë 28.1.2021, u konstatua se ajo është e njëjtë me kontratën për sigurimin e shërbimeve të balancimit (kapacitetit rezervë dhe energjisë balancuese) të sistemit elektroenergjetik për periudhën kohore 1.1.2018–31.12.2018, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 184, datë 20.8.2018.

- Veç sa më sipër, shërbimet ndihmëse dhe ato të balancimit janë elemente kryesore në garantimin e sigurisë së operimit të sistemit elektroenergjitik shqiptar. Për periudhën deri në hyrjen në fuqi me efekte financiare të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 106, datë 2.7.2020, për "Miratimin e rregullave të tregut shqiptar të balancimit të energjisë elektrike", KESH sh.a. si kompani e ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik ka qenë dhe vijon të jetë ofrues i këtyre shërbimeve.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Zgjatjen e efekteve juridike të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 184, datë 20.8.2018, "Mbi miratimin e 'Kontratës për sigurimin e shërbimeve të balancimit (kapacitetit rezervë dhe energjisë balancuese) të sistemit elektroenergjitik për periudhën kohore 1.1.2018–31.12.2018' midis OST sh.a. dhe KESH sh.a.".

2. Kontrata do të shtrijë efektet nga data 1 janar 2021 deri në hyrjen në fuqi me efekte financiare të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 106, datë 2.7.2020, për "Miratimin e rregullave të tregut shqiptar të balancimit të energjisë elektrike".

3. Drejtoria e Monitorimit të Tregut dhe Inspektimeve të njoftojë shoqëritë KESH sh.a. dhe OST sh.a., si dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet juridike nga data 1 janar 2021.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti